



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1097/3 Prot.

Tiranë, më 07.08.2025

V E N D I M

Nr. 182, datë 07.08.2025

Bazuar në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 161, datë 15.07.2025¹, e paraqitur nga z. A.N kundër Bashkisë Mirditë me pretendimin për diskriminimin për shkak të “*bindjes politike*”².

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe me e-mailin datë 29.07.2025, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “*Kam ushtruar funksionin e specialistit të certifikuar në IT, pranë Bashkisë Mirditë për një periudhë prej 17 vitesh, duke realizuar me sukses detyrat e mija si webmaster dhe menaxher i faqeve zyrtare të Bashkisë, trajnues i stafit, si dhe kam realizuar mbështetje permanente për infrastrukturën IT.*”

Pas një pune disa vjeçare në këtë bashki, edhe si trajnues i administratës, zëdhënës shtypi dhe mbështetës i problemeve teknike elektronike nëpër zyra, me datë 02.11.2019, kur u inaugurua rikonstruksioni modern i Pallatit të Sportit “Arjana Arapi”, nga drejtuesi i bashkisë në atë kohë mu kërkua që të merrja drejtimin e këtij institucioni, jo si “teknik ndërtimi”, por si specialist i IT-së, pasi rikonstruksioni rrënjësor instaloj shumë elementë elektronikë si: kamerat monitoruese, sensorë kundër duhanit, zjarrit dhe klime, por mbi të gjitha implementimi i procedurave të

¹ Ankesa është plotësuar me informacionin dhe dokumentacionin e dërguar me e-mail-in datë 29.07.2025.

² Referuar Kartës së Anëtarësisë nr. 051330/2015, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë dhe shkresës nr. 05, datë 29.07.2025, të lëshuar nga dega e Partisë Socialiste të Shqipërisë, të Bashkisë Mirditë, vërtetohet se A.N është anëtar dhe aktivist i subjektit politik: Partia Socialiste e Shqipërisë.

transmetimit online të ndeshjeve, detyra këto që nuk i bën një teknik i mesëm ndërtimi si thuhet se është sot, por një specialist i mirëfilltë IT-je.

Gjatë gjithë kësaj periudhe vijova të punoj paralel dhe si korrespondent i dy gazetave të shtypit Qendror si: gazeta “Koha Jonë” dhe “Tirana Observer”.

Në periudha të ndryshme kohore, jemi përballur me situata të rënda kriminale në qytetin e Rrëshenit dhe më gjerë. Si individ me statusin e gazetarit dhe i përgjegjshëm ndaj opinionit publik në kohë të ndryshme, në mungesë të forcës vepruese të policisë, qytetarët prisnin shumë nga pozicioni që mbaja.

Është fakt i njohur se unë me të drejtën që më jepte statusi i gazetarit por edhe përgjegjësia ime përballë qytetarëve, në vite kam denoncuar fenomene të ndryshme që ndodhnin në qytet, denoncime që u solli shumë probleme autorëve të këtyre veprimeve.

Duhet të saktësoj se edhe mua mu bënë shumë kërcënime, deri edhe sulme fizike në ambientet e një biznesi të vogël familjar ku punonte bashkëshortja ime. Erdhi një kohë që këto kërcënime apo sulme deri fizike pushuan dhe kujtova se rashë në qetësi, për tu marrë me punë krijuese, vetëm kulturore e historike, por kisha gabuar. Çuditërisht këto sulme nuk vonuan të shfaqeshin në mënyrë më të kamufluar me firma e vula bashkiake. I theksoj këto për të evidentuar faktin se edhe pse me metodat e mija denoncuese mediatike, i shërbeva qytetarëve, rendit publik, etj, disa individë kanë tentuar të më paraqesin si një “opozitar politik” duke shpikur, se unë kisha qenë “kundër pushtetit” aktual në bashki.

Ajo çfarë është vetë denoncuese në këtë rast, është se lidhshipi i ri, pra ajo pjesë e shoqërisë që ishte në opozitë kur drurëve dekorativë u hidhej naftë, nuk priti pak kohë, sa për të humbur gjurmë, por me të marrë drejtimin, nisi një sulm të koordinuar dhe të pa precedent ndaj meje.

Fillimisht nisën me një akuzë, sipas të cilës ishte zhdukur pa lënë gjurmë një kontejner banimi në raste emergjencash, që ka qenë thjeshtë nën ruajtje në rrethimin e ambienteve sportive. Në dy orë e shfryva këtë tullumbace fyese, teksa shkova në vendin ku vetë bashkia e kishte transferuar, dhe pasi e fotografova i mora një deklaratë poseduesit, këta heshtën. (bashkëlidhur foto dhe deklarata).

Nuk vonoi veçse pak ditë më akorduan, një nga ato vërejtjet tip fletë-rrufeve të kohës së revolucionit kinez, se nuk kisha marrë leje në bashki, për të marrë pjesë në një aktivitet të bashkisë, të lajmëruar në faqen zyrtare të bashkisë, dhe një vërejtje tjetër duke thyer afatet ligjore mes vërejtjeve, kjo e fundit nuk mund të kishte një vijuese, pasi largoheshe nga puna. (bashkëlidhur faktet).

Kujtova se deri këtu e kishin, mbase do ndryshonin qëndrim, e në fakt ndryshuan. Me një vendim, Pallatin e Sportit për të cilin janë shpenzuar miliona lekë, duke e kthyer atë ndër më modernit në vend, e bashkuan me pastrimin e qytetit dhe brigadën e ndërtimit. Kjo u bë me qëllim largimin tim dhe në të vërtetë ashtu ndodhi, se pas kësaj e shikova veten në pozicion të tillë pune, citoj: “Punonjës i shërbimeve të tjera elementare”.

Nuk u kujdesën të më lënë ndonjë specialist, apo me ndonjë përcaktim më të moderuar, por më barazuan me ndonjë që vjen rishtazi, pa përvojë e specializim elementar. Pra, sipas këtij përcaktimi unë duhej të punoja si punëtor i mbledhjes së mbeturinave, apo në hapje kanalesh, që ndonëse janë punë të nderuara, nuk i përkasin formimit dhe kontributit tim.

Pas kësaj i kam dërguar me postë një letër sqaruese Kryetarit të Bashkisë, z. A.M, duke i parashtruar çdo gjë, dhe konfirmuar se nuk mund të shkoj në pozicion të tillë pune, pasi është i padrejtë dhe fyes për kontributin tim. Ky i fundit, thjeshtë e ka firmosur, që të shërbente për mbylljen e librezës time të punës, në datë 15.05.2024.

Edhe një herë theksoj se, në kushtet dhe rrethanat që mu krijuan, duke qenë i diskriminuar edhe në opinionin publik, nuk mund të vazhdoja në atë pozicion pune që më caktuan, pra punë elementare, që përkethehet edhe si punonjësi i ngarkim shkarkimit të kazanëve të mbetjeve”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 1021/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 1097/1, datë 31.07.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Bashkia Mirditë, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kopje të dosjes personale të ankueses (vendim emërimi, transferimi, kontrata pune, kopje të Librezës së Punës, masa disiplinore, etj).
- Kopje të vlerësimit të punës së ankuesit për vitet 2021, 2022 dhe 2023.
- Kopje të plotë të procedurës së ndjekur lidhur me transferimin e ankuesit në datë 30.11.2023, nga “Përgjegjës” në “Punëtorë”.
- Informacion dhe kopje të dokumentacionit mbi studimin/vlerësimin e bërë nga Bashkia Mirditë për ndryshimin e strukturës dhe organigramës së Bashkisë, në muajin shtator 2023.
- Kopje të dokumentit të kriterëve, mbi të cilat është bërë vlerësimi i punonjësve të cilët do transferoheshin dhe tabelës së vlerësimit të tyre.
- Kopje të përshkrimit të punës për pozicionet, “Përgjegjës” i Sektorit të Menaxhimit dhe Monitorimit të Pallatit të Sportit dhe Mjedisëve të tjera Sportive dhe “Punëtorë” në Sektorin e Shërbimeve. Informacion mbi kategorinë e pagës për këto dy pozicione (paga bruto dhe neto).
- Kopje të procedurës së ndjekur lidhur me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin.
- Kopje të plotë të strukturës organizative dhe organikës të Bashkisë Mirditë, të periudhës qershor 2023 dhe të strukturës së ndryshuar të periudhës nëntor 2023.
- Kopje të Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Mirditë”, që ka qenë në fuqi në muajin shtator 2023.
- Informacion nëse kjo çështje po ndiqet gjyqësisht. Nëse po, kopje të kërkesë padisë dhe parashtrimeve të Bashkisë Mirditë.

Me e-mail-in datë 06.08.2025, ankuesi në mes të tjerash, dërgoi pranë Komisionerit dhe kopje të kërkesë padisë drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Pjesë e dokumentacionit të depozituar nga ankuesi, pranë KMD-së, është Kërkesëpadia drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me paditës: subjektin ankues: A.N dhe subjekt të paditur: Bashkia Mirditë.

Bazuar në parashtrimet dhe dokumentacionin e depozituar nga palët në këtë proces, Komisioneri vëren se, në objekt të kërkesë-padisë së ankuesit drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë (*në vijim Gjykatës*), rezulton se pretendimi i ngritur nga subjekti ankues për diskriminim, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Theksojmë se, të njëjtat fakte dhe rrethana janë paraqitur edhe përpara Komisionerit. Po ashtu të njëjtat shkaqe që bëhen prezent në kërkesë padinë e paraqitur para Gjykatës, janë pretenduar dhe tek Komisioneri.

Komisioneri konstaton se, në objekt të kërkesë-padisë së bërë nga ankuesi, pranë Gjykatës, ndër të tjera, kërkohet:

“4. Konstatimin e largimit të padrejtë nga puna si rezultat i presioneve politike dhe degradimit të pozitës”.

Në bazën ligjore të vendosur në kërkesë-padinë e depozituar pranë Gjykatës, me datë 18.06.2024, ankuesi në mes të tjerash ka cituar shprehimisht: *“Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar”.*

Komisioneri konstaton se, në parashtrimet e kërkesë-padisë së bërë nga ankuesi, ndër të tjera, citohet se:

“.... Kam refuzuar këtë lëvizje degraduese dhe për rrjedhojë jam shkëputur nga marrëdhënia e punës, për shkak të pamundësisë për të pranuar një vendim diskriminues dhe të poshtërueshëm profesionalisht.

2. Diskriminim mbi bazë të qëndrimeve të mia politike.

Në cilësinë e gazetarit dhe zëdhënësit, kam denoncuar publikisht fenomene që cenonin rendin publik dhe interesin qytetar. Këto qëndrime janë interpretuar si pozicionim politik, duke u përdorur për të më ndëshkuar profesionalisht.

4. Shkelje e të drejtës për trajtim të barabartë në administratë.

Veprimi ka karakter diskriminues dhe selektiv, bazuar në bindjet ose perceptimet politike, në kundërshtim me nenin 1 dhe 3, të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Bazuar në sa më sipër, pala ankuese, në kërkesën e paraqitur pranë Gjykatës, ka pretenduar, ndër të tjera, trajtimin diskriminues nga ana e punëdhënësit. Ai ka kërkuar dëmshpërblimin përkatës, duke i paraqitur Gjykatës të njëjtat pretendime dhe shkaqe që ka sjellë paralelisht edhe pranë Komisionerit.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, citohet:

“...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara në aktin procedural të kërkesëpadisë. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërtimeve të padisë gjendet në pjesët

përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë.”

Vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë janë një nga kategoritë e akteve me më ndikim në sistemin ligjor shqiptar dhe sidomos në praktikën gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese mundësohet interpretimi i njësuar i ligjit, duke sjellë si pasojë zbatimin e njësuar të tij në rastet konkrete gjyqësore. Përmes vendimeve unifikuese jo vetëm garantohet shteti ligjor si themel kushtetues i Republikës, por i jepet jetë parimit të sigurisë juridike.

Neni 141, i Kushtetutës shprehet se: *“Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore”*. Pra, Kushtetuta shprehimisht i njeh të drejtën dhe detyrimin Gjykatës së Lartë, që përmes Kolegjeve të Bashkuara të unifikojë, ose më saktë, të “njësojë” praktikën gjyqësore. Kjo kompetencë e Gjykatës së Lartë detajohet në ligjin nr. 9877/2008 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar. (Në nenet 14, 16, 17 dhe 19 të të cilit parashikohet mënyra e ushtrimit të saj).

Ky Ligj, normon se: *“Moszbatimi i vendimeve unifikuese, si dhe i vendimeve të tjera të Gjykatës së Lartë, kur, sipas kodeve të procedurave këto vendime janë të detyrueshme përbën shkelje të rëndë disiplinore”*.

Për rrjedhojë, të gjitha vendimet unifikuese janë të detyrueshme për gjykatat dhe moszbatimi i tyre sjell përgjegjësi disiplinore, me pasojë shkarkimin nga detyra të gjyqtarit.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankuesit, të njëjtat fakte, rrethana, shkaqe, parashtrime, janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor.

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: *“... Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”*, si dhe në nenin 33, pikën 7/4 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën me nr. 161, datë 15.07.2025, të z. A.N, dhe deklaron pushimin e shqyrtimit të saj³.

³ Për analogji citojmë vendimet me: nr. 253, datë 28.12.2021, nr. 77, datë 21.04.2022, datë 26.07.2023, nr. 275, datë 14.11.2024 dhe nr. 124, datë 20.05.2025, të Komisionerit.

Neni 33, pika 7/4 e LMD-së, nuk e lidh marrjen dijeni me ndonjë moment të caktuar të procedurës. Kushti që kërkohet nga dispozita e sipërcituar është vetëm fakti që çështja të jetë në shqyrtim, pra të mos ketë përfunduar shqyrtimi i saj me vendim nga ana e Komisionerit.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: *“Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë⁴, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 *“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 32, pika 1, shkronja a), nenit 33, pika 7/4, dhe nenit 36/4, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 161, datë 15.07.2025, të paraqitur nga subjekti ankues, A.N kundër Bashkisë Mirditë, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lezhë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁴ Ose me kërkesë drejtuar Gjykatës, të palës së interesuar në procesin gjyqësor të iniciuar.